Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur anëtarë të familjes,

Po përgatitemi të nisim një vit interesant studimesh në matematikë. Kapitulli i parë u kushtohet *marrëdhënieve vijore*. Këto janë marrëdhënie në të cilat njëra madhësi ndryshon në mënyrë konstante, në përgjigje të ndryshimit të madhësisë tjetër.

Për shembull, Lara fiton 8 $ në orë. Kjo është një marrëdhënie vijore midis ndryshores *orë pune (H)* dhe ndryshores *dollarë të fituar (D)*: meqë fitimet e Larës shtohen me 8 $ për çdo orë që ajo punon. Duke përdorur algjebrën, një marrëdhënie e tillë mund të shprehet kështu: $D = 8 \times H$, ose $D = 8H$.

Do të mësojmë si të dallojmë dhe si të punojmë me marrëdhëniet vijore të paraqitura në tabela, rregulla algjebrike dhe grafikë. Të gjitha marrëdhëniet vijore paraqiten grafikisht si vija të drejta, dhe thjesht duke parë grafikun mund të mësojmë shumë gjëra në lidhje me marrëdhënien.



Orë	Dollarë të fituar
0	0
1	8
2	16
3	24
4	32

Marrëdhëniet vijore i ndeshim në shumë situata të zakonshme: kostoja gjithsej për një numër të caktuar CD-sh, kur çdo CD kushton 15 $; numri i miljeve të përshkuara kur dikush udhëton me 40 milje në orë. Ndonjëherë marrëdhënia mund të mos jetë saktësisht vijore nga ana matematike, por mund të përafrohet në mënyrë të tillë që të na lejojë të përdorim një model vijor, për të bërë parashikime dhe vlerësime.

Fjalor Ja disa terma të rinj që do të mësojmë gjatë kësaj kohe:

koeficient
pjerrësi
ndërprerje në boshtin *y*
forma pjerrësi-ndërprerje
variacion i drejtë
përpjesëtimisht e drejtë
marrëdhënie vijore

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Së bashku me nxënësin, mund të zbaviteni duke kërkuar të gjeni marrëdhënie të tilla dita ditës dhe duke bërë parashikime ose vlerësime në bazë të tyre. Nëse mund të shtypni 40 fjalë në minutë, sa kohë do t'ju duhet që të shtypni një përmbledhje libri? Sa kohë do t'ju duhet të rrini me një fëmijë si dado për të fituar 100 $, në rast se ju paguajnë 4 $ në orë? Marrëdhëniet vijore mund t'i hyjnë në punë nxënësit në planifikim dhe kursim!